



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.200/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 29.01.2025 mori këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.200/2025 e datës 26.01.2025.
- II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 5,500.00 (pesëmijë e pesëqind) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 26.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se më datë 24 Janar 2025, rreth orës 14:00 kandidatja për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, aktualisht Ministre në Ministrinë e Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu përgjatë fjalimit të mbajtur në Komunën e Vitisë në Shtëpinë e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" ka përdorur gjuhë nxitëse dhe urrejtëse ndaj partive kundërshtare ku e njëjta i drejtohet turmës së mbledhur me fjalët "*kundërshtaret tanë, kundërshtarët tanë janë bërë bashkë, pra klanet e krimit dhe korrupsionit janë bërë bashkë*". Parashtresuesi i ankesës vlerëson se në veprimet e znj. Albulena Haxhiu janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar, të përcaktuar në ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Parashtresuesi i ankesës si provë, që dëshmon shkeljen e pretenduar ka bashkangjitur CD-në, me videon e realizuar nga mediumi Nacionale.com, të publikuar në rrjetin social facebook, ku nga minuta 01:56 deri në minutës 02:07, dëgjohet znj. Albulena Haxhiu duke përdorur fjalor të papërshtatshëm, nxitës dhe denigruës ndaj subjekteve politike kundërshtare dhe provën: Ftesa për tubimin e LVV në

Komunën e Vitisë, në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”, për datën 24.01.2025 në ora 13:00 e publikuar në rrjetin social facebook.

Më datë 27.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 28.01.2025 në ora 15:00. Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 29.01.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për faktin se deklarata e kandidatës, në këtë rast Ministres së Drejtësisë znj.Haxhiu për të cilën parashtruesi pretendohet se janë shkelur dispozitat të caktuara zgjedhore që kanë të bëjnë me subjektin e tyre politik në këtë rast PDK-në, konsiderojmë se janë të paqëndrueshme dhe janë në përputhje me rregullativen dhe frymën e një fushate zgjedhore. Sipas parashtruesit të përgjigjes në ankesë znj.Haxhiu, në deklaratën e saj në asnjë rast nuk thekson subjektin e pretenduesit, në këtë rast PDK-në, dhe përveç kësaj nuk përben shkelje të nenit 34 të LPZ-së që ka të bëjë me nxitjen e ndonjë urrejtje apo gjuhe fyese, në këtë rast për subjektin e pretenduesit-PDK.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit të video incizimit të ofruar si provë materiale e cila është publikuar, shihet se ministria znj.Albulena Haxhiu ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese duke nxitur urrejtje subjekteve tjera politike në garë duke ju referuar si kundërshtar, në atë mënyrë që përderisa i ishte drejtuar elektoratit të saj në tubimin e Lëvizjes Vetëvendosje në Komunën e Vitisë përdorë fjalët " kundërshtarët tanë, kundërshtarët tanë janë bërë bashkë, pra klanet e krimit dhe korrupsionit janë bërë bashkë", paneli vlerëson se është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Andaj për Panelin përdorimi i një gjuhe të tillë nxit ose provokon, mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve dhe është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur në rastin konkret ndaj subjekteve tjera politike, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 të LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së. Në këtë rast marrë për bazë kontekstin dhe qëllimin për të cilin

është përdorur gjuha ndaj subjekteve tjera politike në garë duke ju referuar si kundërshtar, faktin që deklarata është bërë gjate tubimit publik në fushatë zgjedhore, sipas Panelit përdorimi

i gjuhës së tillë ndaj kundërshtarëve politikë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese, dhe mund të nxit urrejtje kundrejt të tjerëve.

Sipas Panelit nga përmbajtja e deklaramit te kandidatës për deputet të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje konsiderohet gjuhë nxitëse dhe urrejtëse *kundrejt të tjerëve* në kuadër të fushatës zgjedhore dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe ne përgjithësi atmosfere destabiliteti. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë e për të cilat shkelje paneli ka shqiptuar dënime me gjobë.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 200/2025 më datë 29.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.